

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO			
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT			
MINISTRIA E FINANCËVE / MINISTARSTVO ZA FINANSIJE / MINISTRY OF FINANCE			
AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT / CENTRALNA AGENCIA NABAVKE / CENTRAL PROCUREMENT AGENCY			
Mësimi Org. Org. Jedinice Org. Unit		Nr. Prot. Brig Prot. Prot. No.	
	AQP		3121
Nr. I Faqëve Br. Stranica No. Pages		Data : Datum : Date :	24.02.2024
	1/95		
Prishtinë / a			



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance

AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT

CENTRALNA AGENCIA NABAVKE / CENTRAL PROCUREMENT AGENCY

RAPORT VJETOR I PUNËS I AGJENCISË QENDRORE TË PROKURIMIT

PËR VITIN 2020

Përmbledhje Ekzekutive

Në përputhje me detyrimin ligjor, Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) përgatitë dhe i dorëzon Ministrit të Financave një raport vjetor, që pasqyron aktivitetet e prokurimit publik të udhëhequra nga AQP-ja për atë vit kalendarik. Raporti Vjetor për vitin 2020 i përshkruan aktivitetet e AQP-së në vitin paraprak dhe informon institucionet përkatëse, operatorët ekonomikë dhe të gjithë akterët profesionistë rreth funksionimit të AQP-së. Organizimi i brendshëm dhe funksionimi i AQP-së janë përcaktuar me Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës.

AQP administrohet nga një drejtor i emëruar për një periudhë tre (3) vjeçare. Drejtori udhëheq, organizon dhe drejton punën dhe veprimtarinë e AQP-se dhe është përgjegjës për punën profesionale të AQP-se.

Fushëveprimi i AQP-së, konform Ligjit për Prokurimin Publik, trajton dy (2) lloje kryesore të procedurave të prokurimit:

1. Kontratat e Centralizuara – AQP udhëheq aktivitetet në emër të të gjitha Autoriteteve Kontraktuese; dhe
2. Kontratat e veçanta – AQP udhëheq aktivitete për Agjencitë e Pavarura të cilat i përgjigjen Kuvendit të republikës së Kosovës, që kanë më pak se 50 (pesëdhjetë) punonjës.

Në kuadër të **kontratave të centralizuara në vitin 2020**, AQP gjatë vitit 2020 ka iniciuar 7 (shtatë) aktivitete dhe në kuadër të këtyre aktiviteteve ka nënshkruar 26 kontrata në vlerë totale prej 37,088,196 Euro. Vlera e parashikuar për këto 26 kontratat ishte 38,546,900 Euro, ndryshimi/kursimet e mundshme në mes të vlerës së parashikuar dhe vlerës totale të kontratës janë 1,485,704 Euro, që i bie rreth **3.8%**.

Nga 7 aktivitetet e udhëhequra gjatë vitit 2020, për 2 (dy) prej tyre, "Furnizim me pajisje të IT-se" dhe "Furnizim me peme dhe perime" AQP ka udhëheq aktivitetin me llojin "Kontrate kornize me disa Operatore Ekonomik" për të cilat pjesa e dytë "minitenderimi" do të udhëhiqet nga Autoritetet Kontraktuese. Kjo do të shpie në zvogëlimin e numrit të aktiviteteve të kontratat e përbashkëta sepse gjatë 3 viteve të ardhshme, AK-ese do të udhëheqin minitenderat për pajisje të IT-se. Kjo shpie në ngritje të parimit të efikasitetit dhe në standardizim të pajisjeve të TI. AQP në rastin e aktivitetit "Furnizim me pajisje të IT-se" ka kualifikuar 16 OE, ndërsa në rastin e aktivitetit "Furnizim me peme dhe perime" ka kualifikuar 10 OE që do të thotë do të ketë konkurrence të madhe gjatë minitenderimit, dhe si rrjedhojë do të sigurohen çmime të tregut.

Në kuadër të **kontratave të veçanta në vitin 2020**, AQP gjatë vitit 2020 ka iniciuar 65 (gjashtëdhjetë e pese) aktivitete dhe në kuadër të këtyre aktiviteteve ka nënshkruar 76 kontrata në vlerë totale prej 1,568,937.63 Euro. Vlera e parashikuar për këto 76 kontratat ishte 1,718,409.49 Euro, ndryshimi/kursimet e mundshme në mes të vlerës së parashikuar dhe vlerës totale të kontratës janë 149,471.86 Euro, që i bie **8.7%**.

Të gjitha dokumentet e prokurimit të AQP-së publikohen rregullisht në përputhje me dispozitat ligjore të transparencës dhe me qëllim të promovimit të veprimtarive brenda komunitetit të biznesit, autoriteteve kontraktuese dhe publikut të gjerë.

AQP gjatë vitit 2020 ka pasur gjithsej **103 kontrata aktive**, duke përfshirë kontratat që kanë qenë aktive gjatë tërë vitit, kontratat që kanë skaduar gjatë vitit 2020 dhe kontratat e nënshkruara në vitin 2020. Këto kontrata tregojnë që AQP ka pambushur në plotni vendimin e Qeverisë për procedurat e centralizuara.

Me anë të kontratave të centralizuara është arritur një sukses i dukshëm në kursimin e kohës dhe punës të punonjësve të institucioneve publike dhe operatoreve ekonomikë dhe në uljen e numrit të procedurave të prokurimit publik në Republikën e Kosovës. Një gjë e tillë është çdoherë e nevojshme por sidomos në vitin 2020 që pjesa më e madhe e vitit ka qenë kohë pandemie.

Lista e shkurtesave

AQP – Agjencia Qendrore e Prokurimit
AK – Autoritet Kontraktues
DFSHP - Drejtorati për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme
DPC – Drejtorati i prokurimeve te centralizuara
DPV - Drejtorati i prokurimeve te veçanta
IKAP – Instituti i Kosovës për Administratë Publike
KRPP – Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
LPP – Ligji i prokurimit publik
OE – Operator Ekonomik
MF – Ministria e Financave
RUOPP - Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik
UA – Udhëzimi Administrativ

Përmbledhja

1. Korniza ligjore	5
2. Struktura organizative	6
2.1 DPC Drejtorati për Prokurime të Centralizuara (DPC)	6
2.2 DPC Drejtorati për Prokurime të Veçanta(DPV)	7
2.3 DPC Drejtorati për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme (DFSHP).....	7
3. Drejtorati për Prokurime të Centralizuara	8
4. Drejtorati për Prokurime të Veçanta	15
5. Drejtorati për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme.....	17
6. Aktivitete tjera të zyrtarëve të AQP-së	18
7. Trajnimi.....	18
8. Çështjet që ndikojnë në efikasitetin e AQP-së & Rekomandimet.....	19
Aneksi 1. STRUKTURA ORGANIZATIVE.....	21
Aneksi 2. Lista e aktiviteteve të prokurimit që kanë përfunduar me nënshkrimin e kontratave nga DPV	22
Aneksi 3. LISTA E KONTRATAVE TE CENRALIZUARA NE FUQI.....	28
Aneksi 4. TABELA E PJESEMARRSVE NE TRAJNIME	32

1. Korniza ligjore

Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) është agjenci ekzekutive që funksionon në kuadër të Ministrisë së Financave (MF).

AQP është Autoritet Publik dhe Organizatë Buxhetore në kuadër të MF dhe i nënshtrohet ligjeve dhe rregulloreve që rregullojnë çështjet administrative. Në bazë të Ligjit mbi Prokurimin Publik (LPP) në Kosovë Nr. 04/L-042, neni 95, *i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 (LPP)*, AQP ka përgjegjësinë:

- Me aprovimin paraprak të Ministrit të Financave, AQP mund të kryej në emër të një Autoriteti Kontraktues (AK) një apo me shumë aktivitete të prokurimit me qëllim të ekonomizimit të shpenzimeve (neni 95 paragrafi 1 i LPP)
- Qeveria sipas propozimit të Ministrit të Financave përpilon një listë të mallrave apo artikujve të përdorimit të përbashkët, miratohet në formën e një udhëzimi administrativ. Lista e tillë dhe çdo ndryshim i bërë në të do të publikohet në media dhe të shpallet në faqen e internetit të KRRPP-së (neni 95 paragrafi 2 i LPP). AQP pas miratimit të listës së artikujve të përdorimit të përbashkët, zhvillon aktivitetet e prokurimit për procedurat e centralizuara në emër të AK në nivel qendror dhe AK në nivel lokal.
- Me aprovim paraprak, mundë të udhëheq në emër të një AK një aktivitet prokurimi (neni 95 paragrafi 4).
- Një AK mund të kërkojë nga AQP-ja që ta ndihmojë AK në fjalë në kryerjen e një aktiviteti të prokurimit (neni 95 paragrafi 4)
- Gjithashtu, kryen procedurën e prokurimit për Agjencitë e Pavarura të cilat i përgjigjen Kuvendit të republikës së Kosovës, që kanë më pak se 50 (pesëdhjetë) punonjës (neni 21/A paragrafi 2 i LPP-se).

Te gjitha kontratat e nënshkuara nga AQP janë obligative për AK.

AQP është përgjegjëse për kryerjen e procedurave të prokurimit deri në nënshkrim të kontratës, ndërsa menaxhimi i kontratës bëhet nga AK të cilat i shfrytëzojnë këto kontrata. Të gjitha obligimet monetare që rrjedhin për këto kontrata do t'i paguajnë AK nga kodet e tyre buxhetore.

2. Struktura organizative

Agjencia Qendrore e Prokurimit përbehet nga tri drejtorate: Drejtoria për Prokurime të Centralizuara (DPC) ; Drejtoria për Prokurime të Veçanta (DPV) dhe Drejtoria për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme (DFShP), shih Aneksin # 1.


2.1 DPC Drejtoria për Prokurime të Centralizuara (DPC)

Drejtoria për Prokurime të Centralizuara (DPC) udhëheqë aktivitetet e centralizuara për AK në nivel qendror dhe në nivel lokal;

Përfitimet e mundshme të prokurimeve të centralizuara:

- Me prokurime të centralizuara sigurohen çmime më të mira për shkak të ekonomisë së shkallës përmes blerjes me shumicë;
- Specifikimet e standardizuara për mallra dhe shërbime shpijnë në mallra apo shërbime me kualitative;
- Mundësia e situatave të mundshme të 'konfliktit të interesit' zvogëlohet përmes ndarjes së agjencisë kontraktuese dhe kontraktuesve;
- Puna e përbashkët, nga AQP-ja dhe Njësitë Kërkuese, në hartimin e specifikimeve teknike dhe pjesëmarrjen në procesin e tenderimit rrit kompetencat e personelit të Njësisë Kërkuese në fusha të veçanta të prokurimit publik;
- Procedurat e ankesave do të modernizohen për shkak se ka vetëm një operator ekonomik që bën një ankesë kundër dhënies së kontratës kornizë në krahasim me numrin e madh të mundshme nga një formë e decentralizuar e prokurimit.

DPC ka të punësuar 6 punëtorë dhe ka këtë strukturë:



Kostoja e kësaj Drejtorie në vitin 2020 ishte rreth 38,000 € bruto për të gjithë zyrtarët.

2.2 DPC Drejtorati për Prokurime të Veçanta(DPV)

Drejtorati për Prokurime të Veçanta (DPV) udhëheq aktivitetet e prokurimit për Agjencitë e pavarura DPV ka të punësuar 6 punëtorë dhe ka këtë strukturë:




Kostoja e kësaj Drejtorie në vitin 2020 ishte rreth 38,000 € bruto për të gjithë zyrtarët.

2.3 DPC Drejtorati për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme (DFSHP).

DFSHP ka të punësuar 5 punëtorë dhe ka këtë strukturë:

- U.D. Drejtor i Drejtoratit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme;
- Përkthyesja e gjuhës serbe;
- Përkthyesja e gjuhës angleze;
- Zyrtarja e lartë e personelit;
- Zyrtarja ligjore;
- Zyrtar i logjistikës.

Kostoja e kësaj Drejtorie në vitin 2020 ishte rreth 35,000 € bruto për të gjithë zyrtarët.



3. Drejtorati për Prokurime të Centralizuara

Drejtorati për Prokurime të centralizuara (DPC), konform nenit 95, pika 2 i LPP-se dhe Vendimit të Qeverisë¹ nr.06/27, të datës 30.04.2020, i cili Vendim ndryshon listën e artikujve për prokurime të përbashkëta, respektivisht Udhëzimin Administrativ QRK-Nr.06/2018 për Zbatimin e Prokurimeve Qendrore të Prokurimit Publik², pas miratimit të listës së artikujve të përdorimit të përbashkët nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2020, ka zhvilluar aktivitetet e prokurimit për procedurat e centralizuara të miratuara në këtë Vendim.

Kryerja e procedurave të centralizuara është bërë në pajtim me legjislacionin që rregullon çështjet e prokurimit publik në Kosovë dhe Udhëzimit Administrativ të aprovuar nga Qeveria për listën e artikujve të përdorimit të përbashkët.

Në Vendimin nr.06/27, lista e artikujve përbehej nga 14 (katëmbëdhjetë) aktivitete në nivel qendror dhe atë lokal.

Nr.	Lista e artikujve sipas Udhëzimit Administrativ QRK-Nr.06/2018 për Zbatimin e Prokurimeve Qendrore të Prokurimit Publik	Lista e artikujve sipas Vendimit të Qeverisë nr.06/27 të datës 30.04.2020
1	Furnizimi me karburante (benzin, diesel)	Furnizimi me karburante (benzin, diesel)
2	Furnizimi me mazut	Furnizimi me mazut
3	Furnizimi me letër për fotokopje dhe printim	Furnizimi me letër për fotokopje dhe printim
4	Furnizimi me material zyrtar	Furnizimi me material zyrtar
5	Furnizimi me goma për automjete	Furnizimi me goma për automjete
6	Furnizimi me bileta të aeroplanit	Furnizimi me bileta të aeroplanit
7	Furnizimi me vetura të udhëtarëve	Furnizimi me vetura të udhëtarëve
8	Furnizim me artikuj ushqimor	Furnizim me artikuj ushqimor
9	Furnizim me mobilie	Furnizim me mobilie
10	Furnizimi me ujë të pijes	Furnizimi me ujë të pijes
11	Furnizim me pajisje të TI-së	Furnizim me pajisje të TI-së
12	Furnizim me pemë dhe perime	Furnizim me pemë dhe perime
13	Marrja me qira e veturave të udhëtarëve	Marrja me qira e veturave të udhëtarëve
14	Shërbime fotokopjimi, skanimi dhe printimi – me qira	Shërbime fotokopjimi, skanimi dhe printimi – me qira

Gjatë vitit 2020 DPC ka zhvilluar procedurat e prokurimit për aktivitetet e cekura në Vendimin e Qeverisë me nr. 06/27 të datës 30.04.2020³ të publikuar në web faqen e AQP-së, KRPP-së dhe Qeverisë. Bazuar në vendimin e Qeverisë, DPC ka zhvilluar procedurat e prokurimit për të gjitha aktivitetet e cekura duke hequr ato për të cilat AQP ka kontrata aktive (në implementim e sipër) në vitin 2020 nga vitet paraprake.

AQP gjatë vitit 2020 ka iniciuar 7 (shtatë) aktivitete sepse për 7 (shtatë) të tjera AQP ka kontrata në fuqi dhe janë duke u implementuar nga AK-ese.

¹<https://aqp.rks-gov.net/wp-content/uploads/2020/05/Udhezimi-Administrativ-per-Prokurime-Qendrore-2020.pdf>

² <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18812>

³ <https://aqp.rks-gov.net/wp-content/uploads/2020/05/Udhezimi-Administrativ-per-Prokurime-Qendrore-2020.pdf>

Nr.	Lista e artikujve sipas Vendimit te Qeverise nr.06/27 te datës 30.04.2020	Sqarime plotësuese
1	Furnizimi me karburante (benzin, diezel)	AQP ka udhëhequr aktivitetin vetëm për Nivel lokal sepse për Nivel qendror AQP ka kontrata ne fuqi dhe janë duke u implementuar nga AK-ese
2	Furnizimi me mazut	AQP nuk ka iniciuar këtë aktivitet sepse AQP ka kontrata ne fuqi dhe është duke u implementuar nga AK-ese
3	Furnizimi me letër për fotokopje dhe printim	AQP ka udhëhequr aktivitetin vetëm për Nivel lokal sepse për Nivel qendror AQP ka kontrata ne fuqi dhe janë duke u implementuar nga AK-ese
4	Furnizimi me material zyrtar	AQP ka udhëhequr aktivitetin vetëm për Nivel lokal sepse për Nivel qendror AQP ka kontrata në fuqi dhe janë duke u implementuar nga AK-ese
5	Furnizimi me goma për automjete	AQP nuk ka iniciuar këtë aktivitet sepse AQP ka kontrata ne fuqi dhe është duke u implementuar nga AK-ese
6	Furnizimi me bileta të aeroplanit	AQP nuk ka iniciuar këtë aktivitet sepse AQP ka kontrata ne fuqi dhe është duke u implementuar nga AK-ese
7	Furnizimi me vetura të udhëtarëve	AQP ka udhëhequr këtë aktivitet
8	Furnizim me artikuj ushqimor	AQP ka udhëhequr aktivitetin vetëm për Nivel lokal (Furnizim me bylmet dhe Furnizim me buke) sepse AQP ka kontrata ne fuqi për artikujt tjerë ushqimor dhe janë duke u implementuar nga AK-ese
9	Furnizim me mobilie	AQP nuk ka iniciuar këtë aktivitet sepse AQP ka kontrata ne fuqi dhe është duke u implementuar nga AK-ese
10	Furnizimi me ujë të pijes	AQP nuk ka iniciuar këtë aktivitet sepse AQP ka kontrata ne fuqi dhe është duke u implementuar nga AK-ese
11	Furnizim me pajisje të TI-së	AQP ka udhëhequr këtë aktivitet
12	Furnizim me pemë dhe perime	AQP ka udhëhequr këtë aktivitet
13	Marrja me qira e veturave të udhëtarëve	AQP nuk ka iniciuar këtë aktivitet sepse AQP ka kontrata ne fuqi dhe është duke u implementuar nga AK-ese
14	Shërbime fotokopjimi, skanimi dhe printimi – me qira	AQP nuk ka iniciuar këtë aktivitet sepse AQP ka kontrata ne fuqi dhe është duke u implementuar nga AK-ese

7 (shtate) aktivitetet e iniciuara janë:

Nr.	Titulli i aktivitetit	Ndarja ne Lote
1	Furnizim me letër - Nivel Lokal	6 Lote
2	Furnizim me material shpenzues zyrtar - Nivel lokal	7 Lote
3	Furnizim me Bylmet dhe Furnizim me buke dhe brumera - Nivel Lokal	2 Lot
4	Furnizim me karburante- Nivel Lokal -	6 Lote
5	Furnizim me peme dhe perime	1
6	Furnizim me pajisje te IT-së	1
7	Furnizim me vetura zyrtare	4 Lote

Ne mënyre që t'iu epet mundësia të gjithë OE për të konkurruar, dhe si rrjedhojë të rritet konkurrenca, AQP në të gjitha rastet ka përdorur procedurën e hapur. Kriteri i shpërblimit në 6 (gjashtë) nga 7 (shtatë) aktivitetet është kriteri Tenderi i përgjegjshme me çmimin me të ulët, pra përveç në rastin e aktivitetit "Furnizim me vetura zyrtare" kur është përdorë kriteri i shpërblimit tenderi ekonomikisht me i favorshëm, kriter që mundëson sigurimin e vlerës për parandë.

Në kuadër të 7 aktiviteteve AQP, në mënyre që të inkurajojë pjesëmarrjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesëm ka ndarë aktivitetet në lote dhe si rrjedhojë ka nënshkruar **26 kontrata në vlerë totale prej 37,088,196 Euro**. Vlera e parashikuar për këto 26 kontratat ishte 38,546,900 Euro, ndryshimi/kursimet e mundshme në mes të vlerës së parashikuar dhe vlerës totale të kontratës janë 1,485,704 Euro, që i bie **3.8%**.

Nga 7 aktivitetet e udhëhequra gjatë vitit 2020, për 2 (dy) prej tyre, "Furnizim me pajisje të IT-se" dhe "Furnizim me peme dhe perime" AQP ka udhëheq aktivitetin me llojin "Kontrate kornize me disa Operatore Ekonomik" për të cilat pjesa e dytë "minitenderimi" do të udhëhiqet nga Autoritetet Kontraktuese. Kjo do të shpie në zvogëlimin e numrit të aktiviteteve të kontratat e përbashkëta sepse gjatë 3 viteve të ardhshme, AK-ese do të udhëheqin minitenderat për pajisje të IT-se. Kjo shpie në ngritje të parimit të efikasitetit dhe në standardizim të pajisjeve të TI. AQP në rastin e aktivitetit "Furnizim me pajisje të IT-se" ka kualifikuar 16 OE, ndërsa në rastin e aktivitetit "Furnizim me peme dhe perime" ka kualifikuar 10 OE që do të thotë do të ketë konkurrence të madhe gjatë minitenderimit, dhe si rrjedhojë do të sigurohen çmime të tregut.

AQP-DPC gjatë vitit 2020 ka operuar me **103 kontrata** duke përfshirë këtu edhe 26 marrëveshjet kornizë me disa Operatore ekonomik për "Furnizim me pajisje të teknologjisë informative" me 16 OE dhe "Furnizim me pemë dhe perime" me 10 OE. Të gjitha kontratat aktive janë të paraqitura në **Aneksin 3**. Këto kontrata tregojnë që AQP ka pambushur në plotni vendimin e Qeveris për procedurat e centralizuara.

Tabela e mëposhtme jep detaje të përmbledhura të kontratave të lidhura nga DPC:

Nr. rendor	Titulli i Kontratës	Data e nënshkrimit të kontraktues	Vlera e parashikuar	Vlera e kontraktuar	Ndryshimet e paraqitura në përqindje	Lloji i kontratës	
1	Furnizim me letër Lot 1 - Nivel Lokal	04.08.2020	€ 460,000	€ 377,790	€ 82,210	17.87%	Kontratë kornizë
2	Furnizim me letër Lot 2 - Nivel Lokal	04.08.2020	€ 180,000	€ 156,597	€ 23,402	13.00%	Kontratë kornizë
3	Furnizim me letër Lot 3 - Nivel Lokal	05.06.2020	€ 280,000	€ 235,039	€ 44,960	16.06%	Kontratë kornizë
4	Furnizim me letër Lot 4 - Nivel Lokal	22.06.2020	€ 210,000	€ 176,530	€ 33,470	15.94%	Kontratë kornizë
5	Furnizim me letër Lot 5 - Nivel Lokal	22.06.2020	€ 195,000	€ 161,401	€ 33,599	17.23%	Kontratë kornizë
6	Furnizim me letër Lot 6 - Nivel Lokal	09.08.2020	€ 155,000	€ 124,433	€ 30,566	19.72%	Kontratë kornizë
7	Furnizim me material shpenzues zyrtar Lot 1 - Nivel lokal	23.04.2020	€ 170,000	€ 99,800	€ 70,200	41.29%	Kontratë kornizë
8	Furnizim me material shpenzues zyrtar Lot 2 - Nivel lokal	23.04.2020	€ 100,000	€ 55,330	€ 44,670	44.67%	Kontratë kornizë
9	Furnizim me material shpenzues zyrtar Lot 3 - Nivel lokal	23.04.2020	€ 15,000	€ 12,210	€ 2,790	18.60%	Kontratë kornizë
10	Furnizim me material shpenzues zyrtar Lot 4 - Nivel lokal	24.04.2020	€ 44,000	€ 34,960	€ 9,040	20.55%	Kontratë kornizë
11	Furnizim me material shpenzues zyrtar Lot 5 - Nivel lokal	01.06.2020	€ 43,000	€ 24,840	€ 18,160	42.23%	Kontratë kornizë
12	Furnizim me material shpenzues zyrtar Lot 6 - Nivel lokal	23.04.2020	€ 62,000	€ 36,260	€ 25,740	41.52%	Kontratë kornizë
13	Furnizim me material shpenzues zyrtar Lot 7 - Nivel lokal	23.04.2020	€ 66,000	€ 43,570	€ 22,430	33.98%	Kontratë kornizë
14	Furnizim me Bylmet - Nivel Lokal	06.03.2020	€ 750,000	€ 646,000	€ 104,000	13.87%	Kontratë kornizë

Nr. rendor	Titulli i Kontratës	Data e nënshkrimit të kontraktues	Vlera e parashikuar	Vlera e kontraktuar	Ndryshimet e paraqitura në përqindje	Lloji i kontratës
15	Furnizim me bukë dhe brumëra të tjerë- Kat 5 Lot 2	07.02.2020	€ 2,200,000	€ 2,180,838	€ 19,161	Kontratë kornizë
16	Furnizim me karburante- Nivel Lokal - Lot 1	13.05.2020	€ 9,941,000	€ 9,506,381	€ 434,618	Kontratë kornizë
17	Furnizim me karburante- Nivel Lokal - Lot 2	13.05.2020	€ 5,045,700	€ 5,076,294	€ (-30,594)	Kontratë kornizë
18	Furnizim me karburante- Nivel Lokal - Lot 3	15.05.2020	€ 2,187,800	€ 2,059,998	€ 127,801	Kontratë kornizë
19	Furnizim me karburante- Nivel Lokal - Lot 4	15.05.2020	€ 3,045,900	€ 2,869,485	€ 176,414	Kontratë kornizë
20	Furnizim me karburante- Nivel Lokal - Lot 6	15.05.2020	€ 4,294,500	€ 4,331,855	€ (-37,355)	Kontratë kornizë
21	Furnizim me peme dhe perime	17.08.2020	€ 3,000,000	€ 3,000,000	-	Marrëveshje ⁴ kornizë
22	Furnizim me pajisje të IT-së	01.09.2020	€ 5,400,000	€ 5,400,000	-	Marrëveshje kornizë
23	Furnizim me vetura zyrtare - Lot 1	27.08.2020	€ 396,000	€ 217,470	€ 178,530	Kontratë kornizë
24	Furnizim me vetura zyrtare - Lot 2	27.08.2020	€ 154,000	€ 134,225	€ 19,775	Kontratë kornizë
25	Furnizim me vetura zyrtare - Lot 3	27.08.2020	€ 32,000	€ 27,950	€ 4,050	Kontratë kornizë
26	Furnizim me vetura zyrtare - Lot 4	27.08.2020	€ 120,000	€ 98,940	€ 21,060	Kontratë kornizë
Gjithsej			€ 38,546,900	€ 37,088,196	€ 1,458,704	3.78%

Shkaqet e Ndryshimeve/Kursimeve potenciale

⁴ Marrëveshjet kornize nënshkruhen nga AQP vetëm për OE e kualifikuar ndërsa çmimet ofrohen në fazën e minitenderëve

Arsyet kryesore për ndryshimet domethënëse të paraqitura në Tabelën e mësipërm janë:


Tek aktivitetet e prokurimit **"Furnizim me materiale shpenzuese zyrtare"** kemi një kursim më të theksuar që në masë të madhe ka të beje me ekonominë e shkalles por edhe me konkurrencën e hapur duke ditur se ka numër mjaft të madh të OE që ofrojnë këto produkte në treg. Vlerat e parashikuara nga AQP para inicimit të aktivitetet të prokurimit janë vendosur më vlerat e tregut, mirëpo ofertat e pranuar kanë pasur çmime nen-çmimet e tregut. Meqenëse nuk është plotësuar kushti për trajtim të ofertave me çmime abnormale sipas rregullave të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, janë nënshkruar kontratat të cilat duhet të impelmentohen në përputhje me kushtet e kontratës nga ana e Autoriteteve Kontraktuese.

Tek aktiviteti i prokurimit **"Furnizim me vetura zyrtare"** kemi kursime të arsyeshme në tre lote, vetëm tek Lot 1 kemi kursime më të larta dhe kjo për arsye se numri i veturave në Lot 1 ka qenë shumë më i madh se në Lotet tjera. Derisa në Lotin 2 numri i veturave të kërkuara ka qenë 7, në Lotin 3 numri i veturave të kërkuara ka qenë 1, në lot 4 numri i veturave të kërkuara ka qenë 6, në Lotin 1 numri i veturave të kërkuar ka qenë 22 vetura, dhe si rrjedhojë

kemi pranuar ofertën shumë të favorshme që nuk ka ndodhur në të kaluarën. Vlen të theksohet se çmimi për një veturë i pranuar është 9,800 € duke përfshirë në këtë çmim edhe garancionin e përgjithshëm për dy vite.

Për aktivitetet e prokurimit **"Furnizim me karburante"** në pamjet e paraqitura në tabele shihet një kursim minimal por që duhet të sqarohet që vlera e parashikuara ka qenë dukshëm nën çmimin e tregut dhe është bazuar vetëm në kontratat e kaluara të AQP-së dhe nëse marrim si krahasim çmimin e tregut kontratat kanë çmim më të ulët në shkallën rreth 10%, kjo duke u bazuar p.sh, në çmimet e muajit dhjetor 2020 ku çmimet mesatare të 11 kontratave të centralizuara aktive për furnizim me karburante është **0.8416 €** për litër disel ndërsa çmimi i tregut në këtë muaj ka qenë rreth **0.95 €** për litër disel dhe kur kjo diferencë prej më shumë se 0.1 € në litër që nëse shumëzohet me rreth 30 milion (litra sasia e të gjitha kontratave të centralizuara) atëherë kursimet shkojnë në rreth 3 milion € apo më shumë se 10%. Për këto kontrata AQP planifikon të bëjë një analizë më të detajuar gjatë vitit 2021.

Këto rezultate të kursimeve të mjeteve buxhetore janë arritur falë transparencës, kritereve që rrisin konkurrencën e drejt, mos diskriminimit, përgatitjes profesionale të specifikave teknike të cilat hartohen edhe me përkrahjen e eksperteve nga institucionet tjera dhe gjithashtu falë punës profesionale që kanë treguar zyrtarët e Agjencisë Qendrore të Prokurimit gjatë zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit.



Grafiku nr. 1. Paraqitja grafike e vlerave te kontratave të Centralizuara për vitin 2020

Këto rezultate të kursimeve të mjeteve buxhetore janë arritur falë transparencës, kritereve që rrisin konkurrencën e drejt, mos diskriminimit, përgatitjes profesionale të specifikave teknike të cilat hartohen edhe me përkrahjen e eksperteve nga institucionet tjera dhe gjithashtu falë punës profesionale që kanë treguar zyrtarët e Agjencisë Qendrore të Prokurimit gjatë zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit.

Aktivitetet e prokurimit te centralizuar të cilat janë në procedure, d.m.th akoma nuk janë nënshkruar kontratat janë:

Nr. rendor	Titulli i Kontratës	Gjendja	Vlera e parashikuar
1	Furnizim me Inventar zyrtar dhe shkollor	Në procedurë	€ 6,270,157
2	Shërbime te transportit ajror	Në procedurë	€ 5,100,000
3	Ri tender Furnizim me karburante (benzin dizel) nivel lokal LOT 5 Regjioni i Gjiilanit	Në procedurë	€ 1,318,000
Gjithsej			€ 12,688,157

4. Drejtorati për Prokurime të Veçanta

Drejtorati për prokurime të Veçanta (DPV), konform nenit 21/A, pika 2 e LPP-se, ka zhvilluar aktivitetet e prokurimit për procedurat e veçanta.

Kryerja e procedurave të veçanta është bërë në pajtim me legjislacionin që rregullon çështjet e prokurimit publik në Kosovë.


Në kuadër të kontratave të veçanta në vitin 2020, AQP ka iniciuar 65 (gjashtëdhjetë e pesë) aktivitete dhe në kuadër të këtyre aktiviteteve ka nënshkruar 76 kontrata në vlerë totale prej 1,568,937.63 Euro. Vlera e parashikuar për këto 76 kontratat ishte 1,718,409.49 Euro. Ndryshimi/kursimet e mundshme në mes të vlerës së parashikuar dhe vlerës totale të kontratës janë 149,471.86 Euro, që l bie 8.7%.

Vlera e parashikuar për aktivitetet e zhvilluara në bazë të nenit 21/A të LPP-së caktohet nga Agjencitë e Pavarura kur dërgojnë kërkesat e tyre në AQP për zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit dhe si rrjedhojë ka pas aktivitete të cilat janë anuluar për arsye se ofertat e pranuar kanë tejkaluar në mënyrë substanciale vlerën e parashikuar.

Lista e aktiviteteve të prokurimit që kanë përfunduar me nënshkrim të kontratave është e paraqitur në **Aneksin 2** të raportit.

DPV gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit, varësisht nga natyra apo vlera e parashikuar e kontratës, ka përdorur procedurën e hapur, kuotim të çmimit, procedurën e vlerës minimale apo procedurën e negociuar pa publikim. Kriteri i shpërblimit në të gjitha aktivitetet që është përdorur është kriteri Tenderi i përgjegjshme me çmimin më të ulët.

VLERA E KONTRATAVE SIPAS LLOJEVE TË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT	
Lloji i Procedurës	Vlera e kontratave:
Procedurë e hapur	€ 1,097,077.69
Procedurë e negociuar pa publikimin e njoftimit të kontratës	€ 414,542.00
Procedurë e kuotimit të çmimeve	€ 36,765.23
Procedurë e vlerës minimale	€ 20,584.71
Gjithsejtë	€ 1,568,969.63



Grafiku nr. 2. Vlera e kontratave sipas llojit te procedurës

5. Drejtorati për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme

Aktivitetet kryesore të këtij drejtorati janë si më poshtë:

- Planifikimi i buxhetit, përgatitja e planit të rrjedhës së parës;
- Përgatitja dhe dorëzimi i barazimeve tremujore, gjashtëmujore, nëntëmujore, njëvjeçare dhe barazimi me zyrën e kontabilitetit pranë Departamentit të Thesarit/MF;
- Menaxhimi dhe mirëmbajtja e informatave për burimet njerëzore, logjistike dhe përkthyesve.
- Zhvillimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të politikave dhe procedurave standarde lidhur me buxhetin, financat, burimet njerëzore, logjistikë etj.
- Mbikëqyrja dhe monitorimi i proceseve të rekrutimit dhe çështjeve lidhur me BNJ, logjistikë etj.
- Menaxhimi dhe mirëmbajtja e informatave për zyrën e përkthimeve.

Sipas Ligjit nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 si dhe Ligjin Nr. 07/L-014 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit me Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, Agjencia Qendrore e Prokurimit, në tabelën në vijim ka prezantuar shpenzimet në totalin prej **166,494.45** Euro, nga tri (3) kategori të ndryshme ekonomike:

Kategoria: Mallra dhe shërbime /Paga dhe mëditje/Komunali	Shuma
Paga dhe mëditje – Janar-dhjetor 2020	134,592.11
Mallra dhe shërbime	30,849.61
Komunali/telefoni fikse	1,054.73
Totali	166,494.45

Ndërsa, nga kategoria kapitale – 10/201/26300/300/18721/0443, Pasuritë jo-financiare/Ndërtimi dhe rindërtimi i shtëpive në pjesën veriore të Mitrovicës rindërtimi i shtëpive, ka pasur **100.000.00** Euro, mirëpo meqë Vendim i Qeverisë Nr. 06/27, të datës 30.04.2020 nuk e ka përfshirë këtë aktivitet të prokurimit në **“Artikujt dhe shërbimet që janë pjesë e prokurimeve të përbashkëta”** dhe si rrjedhojë, këto mjete nuk janë shpenzuar fare ku janë deklaruar si të kursyera dhe janë marr me vendim të Qeverisë.

Gjithashtu, nga kategoria pranim (të hyra jo tatimore), AQP, në përputhje të nenit 29, pika 9 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të prokurimit Publik (RUOPP) të datës 10.04.2019, zyrtari përgjegjës i prokurimit ka nxjerr vendim me nr. të protokollit 62/20 mbi konfiskimin e sigurimit të tenderit për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material shpenzues zyrtar - Nivel Lokal – Lot 7” me nr. të prokurimit; AQP-19-008-111 dhe UA/2016-19-9667/1-1-1, të datës 12.05.2020, Agjencia Qendrore e Prokurimit/MF ka konfiskuar sigurinë e tenderit në shumen prej 1,200 Euro, grupit të OE, Letra Com, SH.P.K, me arsyetimin se OE nuk ka sjellë vërtetimet konform nenit 65 të LPP-së mbi përshtatshmërisë e provueshmërisë, edhe pas afatit shtese që iu është dhënë.

Sa i përket burimeve njerëzore, gjatë vitit 2020, janë kryer katër (4) procese të rekrutimit, prej tyre tre (3) zyrtarë të prokurimit dhe një (1) asistent administrativ, të gjitha këto procedura kanë filluar në vitin paraprak.

Në muajin janar kemi pasur një rast të vdekjes, ndërsa në muajin gusht një (1) pensionim.

Sa i përket angazhimit me kontratë mbi vepër, një zyrtarë ka qenë i angazhuar nga tetori 2019 dhe ka përfunduar kontratën më 26 mars 2020.

6. Aktivitete tjera të zyrtarëve të AQP-së

- Konform dispozitave ligjore, kemi përgatitur Raportin Vjetor për Kontrata të nënshkruara për vitin fiskal 2020 (formën standarde të KRPP-se)
- Konform nenit 95 paragrafi 4, sipas kërkesave të disa Autoriteteve Kontraktuese, kemi dhënë mbështetje dhe këshilla në kryerjen e disa aktiviteteve të prokurimit
